



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:051523

Datë: 08.02.2023

Numri i dokumentit: 03954360

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.102/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Renda (në Objektivin e gjykatës në Veri-Mitrovicë), Kryetari i trupit gjykues Avni Mehmeti, me procesmbajtësen Edita Kelmendi, në çështjen penale kundër të pandehurit L.A, për shkak të veprës penale; Falsifikim i rezultateve të votimit nga nenit 219 par.2 sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (më tej KRPK-së), sipas akuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.I.nr..... e dt.19.04.2022. Pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit fillestar në prezencën e palëve, prokurores së shtetit në PTH në Mitrovicë, Fetije Bajrami dhe të pandehurit L.A, mbrojtësit të tij, av.Qëndrim Rama, seanca ka qenë publike është regjistruar në procesverbal, më dt.01.02.2023 është shpallur publikisht aktgjykimin, ndërsa më dt.08.02.2023 është përpiluar me shkrim ky:

A K T G J Y K I M

I PANDHURI;

L.A nga i ati ....., e ëma ....., e gjinisë ....., i lindur me ..... në fsh..... -Komuna e S....., ku dhe tani jeton në Rr “.....”, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme teknike-makineri, me numër personal të ID;2....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, pranon pension si invalid i luftës UÇK, i gjendjes së dobët ekonomike, ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale, me parë i pagjykuar, për këtë rast është mbrojtur në liri, i njëjti;

SHPALLËT FAJTOR

SEPSE:

Më dt.22.10.2017 në shkollën fillore “.....” në fsh.....-Komuna e S....., në cilësinë e kryesuesit të Këshillit të vendvotimit në Qendrën e votimit ....., vendvotimi me nr..... duke shfrytëzuar pozitën e tij zyrtare apo autoritetin zyrtar në lidhje me zgjedhjet ka shtuar dhe ka hequr votat, në atë mënyrë që pas rinumërimit në Qendrën e numërimit të rezultateve është

bërë krahasimi i të dhënave ku është identifikuar ndryshimi i votave, ashtu që gjatë numërimit të votave të kandidatëve brenda subjektit politik, ka hequr disa vota kandidatëve dhe i ka shtuar disa të kandidatëve të tjerë, duke i regjistruar në mënyrë jo të sakte gjithsej 94 ku prej tyre 90 vota të shtuara dhe 4 vota të hequra.

- Me këtë ka kryer veprën penale; Falsifikim i rezultateve të votimit nga nenit 219 par.2 sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata në mbështetje të nenit 1, 2, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 22, 41, 42, 49, 50, 51, 52, të KPRK-së, të pandehurit L.A, i;

### SHQIPTON

### DËNIM TË KUSHTËZUAR

Ku i caktohet:

- I. DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri brenda periudhës kohore prej një (1) vit pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale të natyrës së njëjtë apo të natyrës më të rëndë, në të kundërtën dënimi do të ekzekutohet.
- II. OBLIGOHET i pandehuri L.A, që të paguaj shpenzimet e procedurës penale, paushallin gjyqësor në shumën prej 20(njëzet) euro si dhe 50 (pesëdhjetë) euro taksë për Fondin për kompensimin e viktimave të krimit, në tërësi shumën prej (70) shtatëdhjetë euro të cilat obligohet t'i paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit.
- III. Kërkesë pasurore juridike nuk kishte.

### A r s y e t i m

- Rrjedha e Procedurës:

Më 6 janar 2021 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Republikën e Kosovës ka ushtruar kallëzimin penal kundër të pandehurit L.A, me dyshimin se ka kryer veprë penale: Falsifikimi i rezultateve të votimit nga nenit 219 par.2 të KPRK-së.

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur aktakuzë PP.I.nr..... më dt.19.04.2022, ndaj të pandehurit L.A, për shkak të veprës penale; Falsifikimi i rezultateve të votimit nga nenit 219 par.2 të KPRK-së.

Gjykata, për këtë lëndë penale në kuadër të kompetencës lëndore e territoriale, ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar më dt.01.08.2023, në të cilin kanë qenë të pranishëm Prokurorja e Shtetit në PTH-Mitrovicë, Fetije Bajrami dhe i pandehuri L.A si dhe mbrojtësit i tij, av.Qëndrim Rama.

I pandehuri L.A në shqyrtimin fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilën ishte akuzuar; Falsifikim i rezultateve të votimit nga nenit 219 par.2 sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

- Shqyrtimi i pranimi të fajësisë:

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri L.A, e në mbështetje të nenit 248 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-ës), në këtë drejtim ka vlerësuar se, janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit L.A, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: Libri i vendvotimit ....., formulari i përputhjes së të dhënave dhe rezultateve të rinumërimit në QNR, formulari i përputhjes së të dhënave të kandidatëve të krijuara në vendvotim ..... dhe e numëruar në QNR, tabela exel e specifikuar me emrin e kandidatit, subjektit politik dhe pasqyra e votave të numëruara në vendvotim dhe rezultati pas rinumërimit në QNR (votat të cilat janë hequr apo shtuar). Të gjitha këto prova dëshmojnë elementet inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimi të fajësisë nga i pandehuri përtej çdo dyshimi është vërtetuar se, i pandehuri L.A ka kryer veprën penale; Falsifikimi i rezultateve të votimit nga nenit 219 par.2 të KPRK-së.

Gjykata ka vërtetuar se, pranimi i fajësisë nga i pandehuri L.A është bërë në mënyrë vullnetare se, i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, duke iu tërhequr vërejtja të pandehurit se, pas pranimi të fajësisë ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, gjykata ka vërtetuar se, aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka pranuar pranimin e fajësisë të deklaruar nga i pandehuri L.A.

- Gjetjet e Gjykatës:

Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë nga i pandehurit dhe nga provat e cekura si më lartë, përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i pandehuri L.A ka kryer veprën penale; Falsifikimi i rezultateve të votimit nga nenit 219 par.2 të KPRK-së.

- Masa e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Gjykata lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, për të pandehurin L.A, ka vlerësuar rrethanat për caktimin, matjen e llojit dhe lartësisë së dënimit në mbështetje të nenit 73 të KPK-ës, e si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar, dashjen e të pandehurit të kjo veprë penale, shkallën e përgjegjësisë penale, kontributin esencial në këtë veprë penale, faktin se këto kjo natyrë e veprave penale kanë qenë shumë të shprehura në Kosovë, faktin se këto vepra penale kanë ndikim negative tek qytetarët e Kosovës, krijojnë mosbesim në institucionet e shtetit, sepse siç dihet përmes rezultatit të votave zgjedhën përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese, gjykata ka vlerësuar se, i pandehuri ka pranuar fajësinë në tërësi për veprën penale, faktin se i njëjti ka shpreh keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë sjelljet e njëjta, sjellja korrekte e të pandehurit në gjykatë, se për herë të para ka ra ndesh me ligjin, ndaj tij para dhe pas këtij rasti, nuk zhvillohet asnjë procedurë tjetër penale, i martuar dhe mbajtës i vetëm i familjes, invalid i UÇK-së me pasoja të dukshme në dorën e djathtë.

Gjykata ka vërtetuar se i pandehuri e ka kryer këtë veprë penale për të cilën edhe është shpallur fajtor, mirëpo të kjo veprë penale është anuluar pasoja nga vepra penale, sepse pas rinumërimit dhe evidentimit të këtyre të metave, Komisionit Qendror i Zgjedhjeve në Kosovë ka korrigjuar rezultatit e votimit në përputhje me rezultatit e të dhënave nga rinumërimi. Gjykata gjen se në veprimet e të pandehurit nuk ka ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese. Andaj, kjo gjykata duke marr parasysh të gjitha rrethanat si me lartë dhe në veçanti pranimin e fajësisë nga i pandehuri duke u mbështetur në nenin 75 par.1 nën par 1.3 të KPRK-së, ka vendosur të pandehurit t'i shqiptoj dënimin nën kufirin e parapa ligjore si dhe dënimin ta kushtëzoj duke besuar se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i cili parashihet me ligj.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendimin e mori në bazë të nenit 450 të KPP-së.

Gjykata nga arsyet e cekura si më lartë e bazuar në nenin 365 të KPP-ës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2022:051523  
Datë: 08.02.2023  
Numri i dokumentit:03954360

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

P.nr.102/2022 i dt.08.02.2023

Procesmbajtësja:

Edita Kelmendi

Kryetari i trupit gjykues:

Avni Mehmeti

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimi të aktgjykimit. Ankesa, i drejtohet gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.